



Programi: Komunikim Masiv dhe Gazetari

Studimet Master

Punim masteri

## RAPORTIMI I MEDIAVE NDËRKOMBËTARE PËR AKTORËT KULTURORË TË KOSOVËS

Kandidatja:  
Lumira Kelmendi

Mentori:  
Prof. Ass. Dr. Hasan Saliu

Prishtinë, 2020

## **ABSTRAKT**

Njëra nga mundësitet kryesore të rritjes së imazhit ndërkombëtar të një vendi është raportimi i mediave ndërkombëtare për atë vend. Megjithëse, nuk është e lehtë të térheqësh vëmendjen e mediave ndërkombëtare, talentë të rinj me prejardhje nga Kosova, me suksesin e tyre kanë arritur që të janë shpesh pjesë e raportimeve të mediave prestigjoze botërore. Ky është edhe qëllimi i punimit, që të identifikohet mbulimi mediatik ndërkombëtar për artistë kosovarë, si një mundësi e rritjes së imazhit të vendit. Nëpërmjet monitorimit të mediave ndërkombëtare, në këtë punim janë identifikuar artikujt e shumtë dhe janë analizuar jo vetëm për nga përbajtja, por edhe shpeshtësia e raportimit dhe intervistave të aktorëve kulturorë kosovarë në mediat si BBC, Daily Mail, The Guardian, New York Times etj, gjatë viteve të fundit. E veçanta është se artistët shqiptarë në vazhdimesi kanë përmendur vendin e prejardhjes së tyre. Punimi konkludon se pavarësisht se Kosova është një vend i vogël dhe pa resurse të mëdha në krahasim me vendet europiane, megjithatë artistët, e veçanërisht këngëtaret me famë botërore, kontribuojnë në ngritjen e imazhit ndërkombëtar të Kosovës.

Fjalë kryç: imazh ndërkombëtar, Rita Ora, BBC, Kosova, kulturë.

## **ABSTRACT**

One of the main possibilities of increasing the international image of a country, is the reporting of the international media about that country. Although it is not easy to attract the attention of the international media, young talents from Kosovo, with their success have managed to be often part of the world's prestigious media reports. This is also the purpose of the thesis, to identify the international media coverage of the artists from Kosovo, as an opportunity to increase the country's image.

Through the monitoring of the international media, in this study many articles have been identified and analyzed, not only in terms of content, but also the frequency of reporting and interviews of Kosovar cultural actors in the media such as BBC, Daily Mail, The Guardian, New York Times, etc., in recent years. What is important is that Albanian artists have consistently mentioned the place of their origin.

This thesis concludes that although Kosovo is a small country and without large resources compared with other European countries, artists, especially the world-famous singers, contribute to raising the international image of Kosovo.

Keywords: international image, Rita Ora, BBC, Kosovo, culture.

## Hyrje

Kultura është një term jashtëzakonisht i gjerë, duke kontribuar kështu në gamën e fushave që bien nën përkufizimin e diplomacisë kulturore. Për shembull, kultura përfshin letërsinë, artin në përgjithësi, zakonet dhe traditat, sjelljen e njeriut, historinë, muzikën, folklorin, gastronominë dhe marrëdhëniet shoqërore.

Diplomacia kulturore është në thelb një proces komunikimi në dy drejtime që përfshin përpjekjet për të promovuar imazhin dhe vlerat e një kombi ndaj audiencave të huaja, si dhe për të kuptuar kulturën, vlerat dhe imazhet e vendeve të tjera dhe njerëzve të tyre. Kuptimi i thjeshtë i diplomacisë kulturore është bashkëveprimi me një vend tjetër përmes kulturave për të arritur interesat e tyre kombëtare.

Diplomacia publike ka kohë që është bërë një koncept i njohur dhe mjaft i përdorur në teorinë dhe në praktikën e komunikimeve ndërkombëtare. Diplomacia publike është komunikimi i aktorëve shtetërore dhe joshtetërore të një vendi me publikët e jashtëm, duke informuar, ndikuar, bashkëpunuar, me qëllim të arritjes së interesave të dëshiruara.

Diplomacia publike është një fushë e re e praktikës dhe dijes. Studimet në diplomacinë publike janë përqëndruar në dy rrafshe kryesore: në interpretime teorike, ku shpjegohen nocionet themelore se çfarë kuptohet me diplomacinë publike apo masive, cila është teoria shpjeguese dhe konceptet për këtë komunikim me publikët e huaj dhe rrafshi i dytë ai i përshkrimit të aktiviteteve praktike, i cili përfshin masat që ndërmerr kjo fushë për realizimin e komunikimit me publikët e huaj.

Diplomacia publike ka tre dimensione kryesore të cilat përdoren për të arritur qëllimet e interesit shtetëror:

1. Menaxhimi i lajmeve të përditshme, reagimi i zhvillimeve aktuale, që paraqet aktivitet brenda orëve dhe ditëve;
2. Komunikimi strategjik, që nënkupton dërgimin e mesazheve ndaj publikëve të huaj duke u përqendruar në aktivitete javore dhe mujore për të ndikuar në perceptimet e opinioneve të jashtme;
3. Krijimi i marrëdhënieve afatgjata, e cila kërkon aktivitete me vite për të arritur mirëkuptim dhe bashkëpunim për vlera të përbashkëta.

Diplomacia e re publike nuk kufizohet më vetëm me mesazhet, fushatat e promovimit apo edhe

kontaktet e drejtpërdrejta qeveritare me publik të huaj, që shërbejnë për qëllime të politikës së jashtme. Ka të bëjë edhe me ndërtimin e marrëdhënieve me aktorët e shoqërisë civile në vendet e tjera dhe me bashkëpunimin midis palëve joqeveritare jashtë vendit.

Imazhi i një vendi në botën e jashtme është mjaft i rëndësishëm, për shkak se duke pasur një imazh të mirë, shteti arrin të realizojë politikën e saj të jashtme. Ngritja e imazhit të një shteti, kërkon një sërë aktivitetesh për t'i bërrë opinionet e jashtme që të dëshirojnë atë që edhe ne e dëshirojmë. Mjetet e komunikimit masiv, si radio dhe transmetimet e programeve televizive ndërkombëtare, gazetat dhe revistat, programet kulturore shkëmbbyese, sportet, librat, shërbimet e lajmeve etj., janë ndoshta formësuesit më të mëdhenj të imazhit, përfshirë këtu edhe arsimimin dhe udhëtimet, si përvojë personale që luajnë rol të rëndësishëm në krijimin e imazhit.

Shtetet investojnë në rritjen e imazhit, por në disa raste kjo nuk mund të menaxhohet dhe ndikimin më të madh e kanë mediat. Sepse, menaxhimi i informacionit që realizohet përditshëm kryesisht përmes mediave e internetit, përdoret si kanal komunikimi për përcjelljen e sa më shumë informacioneve pozitive për vendin e vet mbi publikët e huaj, me qëllim të informimit, ndikimit dhe angazhimit të tyre. Prandaj, si objekt studimi, do të merren mediat ndërkombëtare.

Në këtë punim, trajtojmë në veçanti ndikimin e artistëve shqiptarë në promovimin dhe krijimin e imazhit të mirë të Kosovës në arenën ndërkombëtare. Në këtë aspekt, trajtohet raportimi i mediave të ndryshme ndërkombëtare dhe ndikimi i tyre në rritjen e imazhit të Kosovës, duke vënë theksin në sukseset e artistëve shqiptarë në ngjarjet më të rëndësishme kulturore në botë. Kemi parasysh këtu, se artistë me prejardhje nga Kosova shpeshherë kanë triumfuar me paraqitjet e tyre në botë. Nuk është e lehtë të fitosh vëmendjen e mediave të njohura botërore si Daily Mail, The Guardian, New York Times, BBC News etj.

Rita Ora, Dua Lipa, Bebe Rexha, Ramë Lahaj, janë emra tashmë të njohur botëror, kjo përfaktin se pasqyrimi i këtyre mediave botërore ka qenë dhe vazhdon të jetë pozitiv karshi këtyre aktorëve kulturor.

Dhe, ajo që është e rëndësishme të theksohet, është se në këtë punim janë identifikuar media prestigjioze botërore, të cilat kanë raportuar jo vetëm për sukseset e artistëve në ceremonitë më të rëndësishme muzikore, por ato kanë raportuar edhe për prejardhjen e tyre shqiptare, duke e përmendur edhe shtetin e Kosovës dhe në këtë mënyrë është ngritur edhe imazhi i Kosovës në botë.

Duke pasur parasysh, që në vendin tonë mungojnë studime për diplomacinë publike, pranë ndryshe janë të pakta studimet që janë marr me këtë fushë, përvëç studimit me titull “Komunikimi në diplomacinë publike” i autorit Hasan Saliu, i cili njëherit më ka ndihmuar

jashtëzakonisht shumë gjatë punimin tim, përderisa literatura tjetër që kam përdorur ka qenë kryesisht e huaj.

Ky punim sjellë, një pasqyrë të raportimit të mediavë ndërkombëtare dhe reflektimit të tyre karshi aktorëve kulturorë shqiptarë, gjë që nuk është bërë më herët.

Pastaj, në këtë punim janë identifikuar dhe analizuar artikuj të shumtë të mediave të ndryshme botërore, të cilat kanë shkruar për aktorët e suksesshëm kulturorë shqiptar.

Nga ky punim, janë nxjerrë rezultate, të cilat bëjnë që të reflektojmë dhe kontribuojmë më shumë në këtë aspekt, duke ju referuar institucioneve shtetërore dhe mediave, sepse ata kanë rolin kryesor në ngritjen e këtyre vlerave kulturore.

Përmes ngritjes së vlerave kulturore, ky punim na sjellë në vëmendje se kontributi në këtë fushë, do të thotë zhvillim dhe ngritje e imazhit të shtetit, sepse një ftesë ose koncert, apo një reportazh special i aktorëve të suksesshëm botërorë në Kosovë është e barabartë me promovim dhe imazh pozitiv të shtetit tonë.

### **Qëllimi i punimit të masterit;**

Ky punim ka për qëllim të hulumtojë, identifikojë dhe të përshkruajë raportimin që kanë bërë mediat ndërkombëtare për aktorët shqiptarë në botë, të cilët me sukseset e tyre në profesionin që ushtrojnë njëherësh duke pasur edhe mbulim mediatik ndërkombëtar, kontribuojnë edhe në rritjen e imazhit ndërkombëtar të Kosovës.

### **Objektivat;**

Nëpërmjet këtij studimi janë identifikuar mediat e ndryshme ndërkombëtare të cilat kanë raportuar për artistët në fusha të ndryshme kulturore të Kosovës;

- Janë analizuar përbajtjet e këtyre mesazheve mediatike që u kanë dhënë hapësirë aktorëve kulturorë të Kosovës;
- Janë analizuar mesazhet e mediave ndërkombëtare për mbulimin mediatik që u kanë bërë pjesëmarrësve të Kosovës në ngjarje të rëndësishme botërore si Grammy Awards, Oscars, Brit Awards etj., si dhe sukseset e artistëve nga Kosova si Rita Ora, Dua Lipa e Bebe Rexha etj.

### **Pyetjet qe shtrohen;**

1. Çfarë kanë raportuar mediat e huaja për aktorët kulturorë me prejardhje nga Kosova për sukseset e tyre në karrierë apo sukseset në evenete ndërkombëtare kulturore?

2. Cilat media kanë pasur mbulim më të madh mediatik për aktorët kulturorë kosovarë dhe përse e kanë pasur pikërisht ato këtë raportim të shtuar krahasimisht me mediat e tjera?
3. Çfarë qasje kanë pasur mediat e huaja në pasqyrimin aktorëve nga Kosova?
4. Si ka ndikuar në imazhin e Kosovës, mbulimi mediatik ndërkombëtar i sukseseve të aktorëve kosovarë?

### **Rëndësia e temës;**

Tema që kam trajtuar në këtë studim, ka një rëndësi të madhe, sepse Kosova si shteti më i ri në Evropë dhe si një vend që po kalon periudhë të tranzicionit, duhet të krijoj një imazh sa më të mirë në botë. Dhe këtë gjë, kush më së miri e dëshmon përvçe se sukseset e artistëve nga Kosova në fusha të ndryshme kulturore.

### **Metodologja;**

Metodologja që është përdorur në këtë punim është e kombinuar (kuantitative dhe kualitative), duke filluar me kërkimin bibliografik për të shpjeguar konceptet dhe nocionet që përdoren në punim, me pas janë monitoruar dhe analizuar mesazhet e këtyre mediave për aktorët kulturorë kosovarë, ndërsa gjithashtu janë kuantifikuar sasia e mesazheve që kanë dhënë media të ndryshme brenda një periudhe të caktuar kohore. Për këtë qëllim, janë marrë si objekt studimi kryesish mediat e shkruara, por edhe elektronike, si psh: “Daily Mail”, “BBC News”, “The Telegraph”, “The Times”, “The Guardian”, “The New York Times”, “CNN News”, “The Independent”, “Sky News”, “Fox News”, “Aljazeera”, “The Sun”, “Forbes”, “The Hollywood life”, “Gala”, “Vogue”, “Voice of Athens” e disa të tjera.

Viteve të fundit, kemi pasur raste të shumta të sukseseve të artistëve shqiptarë, ndër të cilët do të veçojmë këngëtaren Dua Lipa e cila shkroi historinë si fituese e dy çmimeve Grammy duke u bërë shqiptarja e parë që fitoi këtë çmim, pastaj sukseset e tenorit Ramë Lahaj dhe bashkëpunimi me tenorin e njojur Placido Domingon. Poashtu Rita Ora, doli fituese në gara muzikore, ajo fitoi çmimin “Best Dance” në MTV Video Music Awards.

Është përfshirë edhe koncerti madhështorë i artistëve të njojurë shqiptarë për himnin e Nënës Terezë që është mbajtur në Vatikan. Pastaj pjesëmarrjet e artistëve në festivale të rëndësishme ndërkombëtare etj.

### **Përbledhje;**

Punimi ndahet në katër kapituj.

**Në kapitullin e parë** është bërë një shpjegim bibliografik mbi nocionin e diplomacisë publike, rolin e saj, pastaj zhvillimin ndër vite të termit diplomaci publike, dimensionet e diplomacisë publike, imazhi i shtetit etj.

**Në Kapitullin e dytë dhe të tretë** është bërë identifikimi dhe përshkrimi i mediave ndërkombëtare të cilat kanë raportuar dhe shkruar për artistët shqiptarë, Rita Ora, Dua Lipa dhe Bebe Rexha, pasqyrimin e tyre në raport me sukseset, origjinën, familjen e artistëve shqiptarë nëpër botë dhe cilët kanë qenë artistët që më shumë kanë tërhequr vëmendjen e mediave botërore. Pastaj, kapitulli i tretë trajton edhe mediat e tjera ndërkombëtare përveç atyre britanike, poashtu dhe ngjarjet dhe pjesëmarrjet e aktorëve shqiptarë në skenat ndërkombëtare si dhe ndikimin e mediave ndërkombëtare në ngritjen e imazhit të Kosovës.

**Në kapitullin e katërt** janë interpretuar të dhënat e grumbulluara, duke i vendosur në perspektivën krahasuese ndërmjet modelit teorik të pranuar gjérësisht nga njëra anë, dhe rezultatet e të dhënavë që kanë dalë nga hulumtimi i raportimit të mediave ndërkombëtare. Pas paraqitjes së këtyre të dhënavë janë nxjerrë edhe përfundime mbi bazën e argumenteve, si dhe janë dhënë këshillat e dala nga ky studim. Poashtu, janë nxjerrë rekomandimet edhe për institucionet shtetërore, se cilat janë strategjitet dhe menaxhimi më efektiv, në mënyrë që mediat ndërkombëtare të pasqyrojnë sukseset e tyre dhe më pas kjo të ndikojë në ngritjen e imazhit të Kosovës.

## Bibliografia

- Nye Jr., Joseph S. *Soft Power The Means To Success In World Politics*. New York: Public Affairs, 2004.
- Saliu, Hasan. *Komunikim në Diplomacinë Publike, Soft Power-i dhe Imazhi Ndërkombëtar i Kosovës*. Prishtinë: Kolegji AAB, 2015.
- Melissen, Jan. *The New Public Diplomacy: Soft Power in International Relations*. Palgrave MacMillan, 2005.
- Nye Jr., Joseph S. *The Paradox of American Power*, Oxford University Press, 2002, and Soft Power, 2004.
- Leonard, Mark. *Public Diplomacy*. London: The Foreign Policy Center, 2002.
- Kunczik, Michael. *Images of Nations and International Public Relations*. New Jersey: Lawrence Erlbaum Associates-Publishers, 1997 në Saliu, Hasan. *Komunikim në diplomacinë publike, Soft power-i dhe imazhi ndërkombëtar i Kosovës*. Prishtinë: Kolegji AAB, 2015.
- Kotler, Philip: Haider, Donald & Rein, Irving. *Marketing Places-Atracting investment, Industry and Tourism to Cities, States and Nations*, Free press, 2002 në Saliu, Hasan. *Komunikim në diplomacinë publike, Soft power-i dhe imazhi ndërkombëtar i Kosovës*. Prishtinë: Kolegji AAB, 2015.
- Tuch, Hans. *Communicating With the World:US Public Diplomacy Overseas*, New York: St Martin's Press, 1990, në Melissen, Jan. *The New public diplomacy: soft power in international relations*. Palgrave MacMillan, 2005.
- E. H. Carr. *The Twenty Years' Crisis 1919–1939: An Introduction to the Study of International Relations* (Basingstoke: Macmillan, 1983 (first edn 1939), në Melissen, Jan. *The New public diplomacy: soft power in international relations*. Palgrave Macmillan, 2005.
- Nye Jr., Joseph S. "Public Diplomacy and Soft Power", in *Public Diplomacy in a Changing World* Annals of the American Academy of Political and Social Science-Sage Publications, inc. 616, (mars,2008), në Saliu, Hasan. *Komunikim në diplomacinë publike, Soft power-i dhe imazhi ndërkombëtar i Kosovës*. Prishtinë: Kolegji AAB, 2015.
- J. Hertz. *'Political Realism Revisited*, International Studies Quarterly, June 1981, në Melissen, Jan. *The New public diplomacy: soft power in international relations*. Palgrave MacMillan, 2005.

## **Artikuj shkencorë**

- Cull, Nicholas J. "Public Diplomacy before Gullion: The Evolution of a Phrase", në CPD Center on Public Diplomacy. University of Southern California, Apr 18, 2006. (vizituar: prill, 2019) <https://www.uscpublicdiplomacy.org/blog/public-diplomacy-gullion-evolution-phrase>
- Cull, Nicholas J. "Public Diplomacy: Taxonomies and Histories, in: Cowan, G. and Cull, N. (eds), The Annals of the American Academy of Political and Social Science: Public Diplomacy in a Changing World, Vol. 616, March 2008. (vizituar: prill, 2019)
- 10 Biggest Public Diplomacy Stories of 2013 në CPD Center on Public Diplomacy, Univesrity of Southern California. (vizituar: qershori, 2019)  
[https://www.uscpublicdiplomacy.org/pdin\\_monitor\\_article/10-biggest-public-diplomacy-stories-2013](https://www.uscpublicdiplomacy.org/pdin_monitor_article/10-biggest-public-diplomacy-stories-2013)
- Cummings Jr., Milton C. *Cultural Diplomacy and the United States Government: A Survey*, Washington, D.C: Center for Arts and Culture, 2003, 1. në Cultural Diplomacy The Linchpin of Public Diplomacy, Report of the Advisory Committee on Cultural Diplomacy U.S. Department of State 2005. (vizituar: maj, 2019)
- Saliu, Hasan. The Evolution of the Concept of Public Diplomacy from the Perspective of Communication Stakeholders. Medijska istraživanja, 26 (1), 69-86. 2020. <https://Doi.org/10.22572/mi.26.1.4>
- Saliu, Hasan. Multiple Target Audiences, Critical Analysis of Pristina-Belgrade Dialogue. *On-line Journal Modelling the New Europe*, 26, 108-123. 2018 Doi:[10.24193/OJMNE.2018.26.08](https://doi.org/10.24193/OJMNE.2018.26.08)
- Saliu, Hasan. The new nature of Cultural Diplomacy in the age of online communication. *Journal of Media Critiques*, 3(10), 87-100. 2017. Doi:[10.17349/jmc117206](https://doi.org/10.17349/jmc117206), <https://www.ceeol.com/search/article-detail?id=697056>
- Saliu, Hasan. International image of the country through strategic communication, Case of Kosovo. *Journal of Media Critiques*. 3(9), 65-76. 2017. Doi: [10.17349/jmc117105](https://doi.org/10.17349/jmc117105)
- Saliu, Hasan. Propaganda and Image in the incident in Kumanovo. *Thesis*, 4(2), 95-105. 2015. Doi.org/10.2139/ssrn.3015687

## **Web informacione:**

- Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës, *Diplomacia publike dhe diplomacia digitale*, 27 korrik 2012 [http://www.mfa-ks.net/al/politika\\_single/3241](http://www.mfa-ks.net/al/politika_single/3241) (vizituar: qershori, 2019)
- Rita Ora on transition from Kosovo refugee to chart reign, BBC News, 27 august 2012  
<https://www.bbc.com/news/av/entertainment-arts-19388985/rita-ora-on-transition-from-kosovo-refugee-to-chart-reign> (shikuar: korrik, 2019)
- Bhvishya Patel, Rita Ora surprises 400 schoolchildren back home in her native Kosovo to support

*Soccer Aid for UNICEF 2019, Daily Mail, 10 april 2019*

<https://www.dailymail.co.uk/tvshowbiz/article-6908557/Rita-Ora-returns-native-Kosovo.html>

(shikuar: korrik, 2019)

Oculus News, *Rita Ora: It's very important for me and my family to speak in Albanian, 2019*

<https://www.ocnal.com/2018/11/rita-ora-its-very-important-for-me-and.html> (vizituar:shtator, 2019)

Clemmie Moodie, *Rita Ora's journey from Kosovo to Coutts: Singer proves hard work pays as her personal fortune tops £100M*, Daily Record, 4 april 2015 <https://www.dailyrecord.co.uk/entertainment/celebrity-interviews/rita-oras-journey-kosovo-coutts- 5456219> (vizituar: korrik, 2019)

Laura Armstrong, *How 'Rita Pita' escaped persecution in war-torn Kosovo for safety and stardom in the UK*, The Sun, 5 April 2016

<https://www.thesun.co.uk/archives/news/8474/how-rita-pita-escaped-persecution-in-war-torn-kosovo-for-safety-and-stardom-in-the-uk/> (shikuar: shtator, 2019)

Channel4 News, *Rita Ora: honorary ambassador for Kosovo, 10 july 2015*

<https://www.channel4.com/news/rita-ora-british-singer-kosovo-honorary-ambassador>

Independent.ie, *Ora named ambassador for Kosovo, 10 july 2015*

<https://www.independent.ie/entertainment/music/ora-named-ambassador-for-kosovo- 31367367.html> (vizituar: shtator, 2019)

John Walsh, *Rita Ora interview: The singer on The X Factor, performing at the Oscars, and being an ambassador to Kosovo*, Independent, 24 october 2015

<https://www.independent.co.uk/news/people/profiles/rita-ora-interview-the-singer-on-the-x-factor- performing-at-the-oscars-and-being-an-ambassador-to-a6705251.html> (shikuar: shtator, 2019)

The Telegraph, *My family fled Kosovo to escape the war - now I want to help the women left behind, 29 march 2019*

<https://www.telegraph.co.uk/women/life/rita-ora-fled-kosovo-escape-war-now-want-help-women-left-behind/> (vizituar: korrik, 2019)

Sebastian Murphy Bates, *Rita Ora returns to her homeland Kosovo to celebrate 10 years of independence: Singer makes triumphant return years after her family fled*, Daily Mail, 18 february 2018

<https://www.dailymail.co.uk/news/article-5403745/Rita-Ora-meets-Kosovos-prime-minister-ahead-show.html> (vizituar: shtator, 2019)

[https://www.instagram.com/p/BfUn7XPnCzf/?utm\\_source=ig\\_embed](https://www.instagram.com/p/BfUn7XPnCzf/?utm_source=ig_embed)

Tom Acres, *Singer Rita Ora jets to Kosovo for independence party* Sky News 18 February 2018  
<https://news.sky.com/story/singer-rita-ora-jets-to-kosovo-for-independence-party-11255498>

Rita Ora - Do They Know It's Christmas (Christmas in Washington 2014),  
[https://www.youtube.com/watch?v=b\\_VBG42lGNQ&list=RD\\_b\\_VBG42lGNQ&index=1](https://www.youtube.com/watch?v=b_VBG42lGNQ&list=RD_b_VBG42lGNQ&index=1)

Daniel D'addario, *Watch Rita Ora Perform 'Grateful' at the Oscars*, Time, 22 february 2015  
<https://time.com/3717244/oscars-2015-rita-ora-grateful/> (vizituar: shtator, 2019)

Monica Almeida, *Rita Ora prepared to perform the song "Grateful" from Beyond the Lights*, New York Times, 2015  
<https://www.nytimes.com/interactive/projects/cp/oscars-2015/backstage/20150222OSCARSBACKSTAGE-slide-Y8RZ> (vizituar: korrik, 2019)

Lisa McLoughlin, *Avicii wins Best Dance Video at MTV VMAs four months after his tragic death as Rita Ora accepts the gong in his honour*, Daily Mail, 21 august 2018  
<https://www.dailymail.co.uk/tvshowbiz/article-6081991/Avicii-wins-Best-Dance-Video-MTV-VMAs-four-months-tragic-death.html> (vizituar: shtator, 2019)

<https://www.president-ksgov.net/en/news/president-jahjagas-remarks-at-the-ceremony-of-presidential-medal-of-honorary-ambassador-for-rita-ora>  
<https://www.youtube.com/watch?v=G8ZVFH1KUfU>

Steve Dove, *Rita Ora Performs "Grateful" at the 2015 Oscars*, abc Oscars, 27 february 2015  
<https://oscar.go.com/news/music-moments/2015-oscar-performance-by-rita-ora-grateful>  
<https://www.youtube.com/watch?v=BrbBHcxDd5E> (vizituar: shtator, 2019)

Mel Evans, *Rita Ora is an actual goddess as she returns to homeland Kosovo for independence day concert*, Metro, 18 february 2018  
<https://metro.co.uk/2018/02/18/rita-ora-actual-goddess-returns-homeland-kosovo-independence-day-concert-7321912/> (vizituar: shtator, 2019)

Emily Yahr, Manuel Balce Ceneta, *TNT drops 'Christmas in Washington,' another blow for producer George Stevens*, The Washington Post, 15 december 2014  
<https://www.washingtonpost.com/news/arts-and-entertainment/wp/2014/12/15/tnt-drops-christmas-in-washington-another-blow-for-producer-george-stevens/>

Emma Kelly, *Rita Ora provides a new terrifying trend for us to try as she sports completely see-through dress at VMAs*, Metro, 21 august 2018  
<https://metro.co.uk/2018/08/21/rita-ora-provides-a-new-terrifying-trend-to-try-as-she-sports-see-through-dress-at-vmas-8900410/>

[completely-see-through-dress-at-vmas-7863708/](https://www.dailymail.co.uk/femail/article-5506661/Dua-Lipa-performing-school-talent-contest-aged-12.html) (vizituar: shtator, 2019)

Dua Lipa - New Rules (The Brit Awards 2018), 21 february 2018

[https://www.youtube.com/watch?v=jBDVf\\_8vzXE&list=RDjBDVf\\_8vzXE&start\\_radio=1&t=18](https://www.youtube.com/watch?v=jBDVf_8vzXE&list=RDjBDVf_8vzXE&start_radio=1&t=18)

Jennifer Wiley & Emily Chan, *She's always had it! Newly unearthed footage shows Dua Lipa displaying her star quality at the age of just 12 at a school talent contest in Kosovo*, Daily Mail, 16 march 2018

<https://www.dailymail.co.uk/femail/article-5506661/Dua-Lipa-performing-school-talent-contest-aged-12.html> (vizituar: janar, 2020)

Mark Savage, *Dua Lipa makes Brit Awards history*, BBC News, 13 January 2018 <https://www.bbc.com/news/entertainment-arts-42677238> (vizituar: janar, 2020)

Ben Beaumont Thomas, *Brit awards nominations 2018: Dua Lipa beats Ed Sheeran with five*, The Guardian, 13 January 2018

<https://www.theguardian.com/music/2018/jan/13/brit-awards-nominations-2018-dua-lipa-ed-sheeran> (vizituar: shkurt, 2020)

Lisa McLoughlin & Ekin Karasin, *Dua Lipa's New Rule: Breakthrough artist is most nominated musician at 2018 BRIT Awards... as she beats Ed Sheeran with incredible FIVE nods*, Daily Mail, 16 January 2018

<https://www.dailymail.co.uk/tvshowbiz/article-5267699/Dua-Lipa-nominated-artist-2018-BRIT-Awards.html> (vizituar: janar, 2020)

Jack Whitehall interviews Dua Lipa The BRIT Awards 2019, 20 february 2019

[https://www.youtube.com/watch?v=PrfJSI1Lkxw&feature=emb\\_title](https://www.youtube.com/watch?v=PrfJSI1Lkxw&feature=emb_title)

Andrew Bullock & Brian Marks, *Dua Lipa says women have 'really stepped up this year' in thinly-veiled dig at lack of female winners in 2018... as she scoops first ever Grammy win and celebrates with devoted family*, Daily Mail, 11 february 2019  
<https://www.dailymail.co.uk/tvshowbiz/article-6690167/Dua-Lipa-gives-inspiring-speech-jabs-Grammy-sexism-beating-field-Best-New-Artist.html>

Ben Sisario, *Grammys 2019: Cardi B, Lady Gaga and Kacey Musgraves Make It a Year for Women*, The New York Times, 10 february 2019

<https://www.nytimes.com/2019/02/10/arts/music/grammy-awards.html> (vizituar: janar, 2020)

Mark Savage & Kev Geoghegan, *Grammys 2019: Lady Gaga, Dua Lipa and Kacey Musgraves dominate*, BBC News, 11 february 2019 <https://www.bbc.com/news/entertainment-arts-47193769> (vizituar: janar, 2020)

Benjamin Lee, *Grammys 2019: Kacey Musgraves and Childish Gambino win big – as it happened*,

The Guardian, 11 february 2019

<https://www.theguardian.com/music/live/2019/feb/10/grammys-2019-live-winners-losers- performances?page=with:block-5c60ef49e4b042feedcbb58f> (vizituar: shkurt, 2020)

Raisin O'Connor, *Dua Lipa wins Best New Artist at the Grammys in first big British win of the night*, Independent, 11 february 2019 <https://www.independent.co.uk/arts- entertainment/music/news/dua-lipa-grammys-best-new-artist- one-kiss-st-vincent-a8773066.html> (vizituar: shkurt, 2020)

Monica Mercuri, *Grammys 2019: Dua Lipa Wins Best New Artist*, Forbes, 10 february 2019

<https://www.forbes.com/sites/monicamercuri/2019/02/10/grammys-2019-dua-lipa-wins-best-new- artist/#262246bd7a15> (vizituar: mars, 2020)

Shaun Walker, *Dua Lipa's father stages music festival for 'peace-loving' Kosovo*, The Guardian, 5 august 2018 <https://www.theguardian.com/music/2018/aug/05/dua-lipa-father-organises-kosovo-music-festival>

Alex Marshall, *Can a Music Festival Make Kosovo Cool?*, The New York Times, 17 august 2018

<https://www.nytimes.com/2018/08/17/arts/music/dua-lipa-kosovo-festival-action-bronson.html>

Jabeen Waheed, *Miley Cyrus puts on a VERY racy display as she slips into an abs-flashing crop top for performance at Kosovo's Sunny Hill Festival*, Daily Mail, 3 august 2019

<https://www.dailymail.co.uk/tvshowbiz/article-7317031/Miley-Cyrus-puts-racy-display-performance-Kosovos-Sunny-Hill-Festival.html> (vizituar: janar, 2020)

Laura Snapes, *How Dua Lipa became the most streamed woman of 2017*, The Guardian, 5 december 2017 <https://www.theguardian.com/music/2017/dec/05/how-dua-lipa-became-the-most-streamed-woman- of-2017-new-rules> (vizituar, shkurt, 2020)

Julian Zyla, *Bebe Rexha, bashkautorja e këngës "The Monster"*, Voice of America, 17 prill 2014

<https://www.zeriamerikes.com/a/bebe-rexha-bashk%C3%A9Autorja-e-k%C3%A9Bng%C3%A9ABs- the-monster-interviste/1895479.html> (vizituar: mars, 2020)

Marie Lodi, *At Least One Person Had Fun at the VMAs*, The Cut, 26 august 2019

<https://www.thecut.com/2019/08/bebe-rexha-2019-vma-awards.html> (vizituar: mars, 2020)

Alyssa Norwin, *Bebe Rexha sparkles in sexy silver dress at 2019 VMAs*, Hollywood life, 26 august 2019 <https://hollywoodlife.com/2019/08/26/bebe-rexha-vmas-2019-dress-photos/>

Bebe Rexha Talks Body Positivity and Her Love of Nandos! The Jonathan Ross Show ITV, 8 april 2019 [https://www.youtube.com/watch?v=b6Q-Ziq\\_bA](https://www.youtube.com/watch?v=b6Q-Ziq_bA) (vizituar: mars, 2020)

Mark Savage, *Bebe Rexha: 'I banged on doors until my hands bled'*, BBC News, 16 June 2018

<https://www.bbc.com/news/entertainment-arts-44455515> ( vizituar: shkurt, 2020)

Lisa Respers, *Bebe Rexha reveals she is bipolar*, CNN News, 27 february 2020

<https://edition.cnn.com/2019/04/16/entertainment/bebe-rexha-bipolar/index.html>

Tyler McCarthy, *Bebe Rexha helping to rebuild Albania following devastating 6.4-magnitude earthquake*, Fox News 4 december 2019 <https://www.foxnews.com/entertainment/bebe-rexha-rebuild-albania-devastating-magnitude-earthquake> (vizituar: mars, 2020)

Alexandra Beni, *Rita Ora is coming to EFOTT Festival, Hungary!*, Daily News Hungary, 10 march 2019 <https://dailynewshungary.com/rita-ora-is-coming-to-efott-festival-hungary/>

Virginie Rousset, *PHOTOS – Jennifer Lopez, Madonna, Rita Ora : les plus belles coiffures de la soirée des MTV Video Music Awards*, Gala Fr, 21 august 2018

[https://www.gala.fr/beaute/beaute\\_de\\_star/photos-jennifer-lopez-madonna-rita-ora-les-plus-belles-coiffures-de-la-soiree-des-mtv-wmas\\_418441](https://www.gala.fr/beaute/beaute_de_star/photos-jennifer-lopez-madonna-rita-ora-les-plus-belles-coiffures-de-la-soiree-des-mtv-wmas_418441) (vizituar: mars, 2020)

Jennifer Ruby, *Rita Ora is surprise choice to perform for Pope at Vatican to celebrate canonisation of Mother Teresa*, Standard UK, 5 september 2016 <https://www.standard.co.uk/showbiz/celebrity-news/rita-ora-is-surprise-choice-to-perform-for-pope-at-vatican-to-celebrate-canonisation-of-mother-a3336716.html> (vizituar: mars, 2020)

Noelle Faulkner, *Dua Lipa on fame, the feminist wave in music and her love-hate relationship with social media*, Vogue, 21 march 2020 <https://www.vogue.com.au/celebrity/interviews/dua-lipa-on-fame-the-feminist-wave-in-music-and-her-lovehate-relationship-with-social-media/image-gallery/0ce1d2835722cb05cc72f99842e5f9fc>

Matthew Symington, *Rita Ora sang for independence, but where is Kosovo heading?*, Al Jazeera, 27 february 2018 <https://www.aljazeera.com/indepth/features/rita-ora-sang-independence-kosovo-heading-180226203608641.html> (vizituar: mars, 2020)

Valerie Hopkins, *Pristina in the spotlight: Rita Ora aside, can Kosovo's capital make it big?*, The Guardian, 19 february 2018 <https://www.theguardian.com/cities/2018/feb/19/pristina-spotlight-rita-ora-kosovo-capital-independence> (vizituar: mars, 2020)

Fjoralba Tuti, *Imazhi i shqiptarëve nga pasqyrimi i shenjtërimit të Nënës Terezë në mediat italiane, 2017* <https://dspace.aabedu.net/bitstream/handle/123456789/1167/03.%20Imazhi%20i%20shqiptareve%20Onga%20pasqyrimi%20i%20shenjtërimit%20te%20Nenes%20Tereze%20ne%20mediat%20italiane%20-%20Fjoralba%20Tuti.pdf?sequence=1&isAllowed=y>

Koncert per ndër te shejntërimit te Nene Terezës Bazilika e Shen Palit Vatikan 03.09.2016, RTK  
<https://www.youtube.com/watch?v=PKlxqn-WJ0A>

Nicoletta Stamati, *Dua Lipa, Rita Ora, bebe Rexha: World pop idols from Albania*, Athens Voice,

26 march 2019

[https://www.athensvoice.gr/culture/music/531329\\_dua-lipa-rita-ora-bebe-rexha-ta-pagkosmia-pop-eidola-apo-tin-alvania](https://www.athensvoice.gr/culture/music/531329_dua-lipa-rita-ora-bebe-rexha-ta-pagkosmia-pop-eidola-apo-tin-alvania) (vizituar: prill, 2020)

*Placido Domingo for Rame Lahaj - December 2017*, publikuar 16 janar 2018

<https://www.youtube.com/watch?v=oWtS9M4RwDU> (vizituar: mars, 2020)

*Dua Lipa - New Rules (Official Music Video)*, publikuar 7 korrik 2017

<https://www.youtube.com/watch?v=k2qgadSvNyU> (vizituar: mars, 2020)

*Bebe Rexha Visits Albania After Deadly Earthquake*, ET Canada, 2 december 2019

<https://www.youtube.com/watch?v=COS6rUsXGeU> (vizituar: mars, 2020)

Operalia, *Placido Domingo, Rame Lahaj*, 2017

<https://www.operaliacompetition.org/single-post/2017/05/03/Rame-Lahaj-joined-Maestro-Domingo-in-Concert-in-Mexico?page=2> (vizituar: janar, 2020)

Ollie Gillman, *A moment I will cherish forever': Rita Ora is the unlikely star at a Basilica concert to celebrate Mother Teresa being made a saint by Pope Francis*, Daily Mail, 5 september 2016 <https://www.dailymail.co.uk/news/article-3773331/A-moment-cherish-forever-Rita-Ora-unlikely-star-Basilica-concert-celebrate-Mother-Teresa-saint-Pope-Francis.html> (vizituar: mars, 2020)

Becky Anderson, *Dua Lipa talks new music, refugees and Brexit*, CNN, 2018

<https://edition.cnn.com/videos/world/2018/11/15/ctw-dua-lipa-new-album-intv.cnn>